

SHEMBULLI THJESHTON ZBATIMIN E UDHËZIMIT Nr.35, datë 07.05.2013 PËR “PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR QËLLIME TË FUSHATËS ZGJEDHORE”.

Gjatë zhvillimit të fushatës zgjedhore, kandidatët mbledhin dhe përdorin të dhëna personale të individëve(zgjedhësve). Shumë shpesh, kandidatët dhe/apo palë të treta të autorizuar, bëjnë fushatë zgjedhore duke lobuar nëpërmjet mënyrave të ndryshme si mesazhe faksi, SMS ose E-mail. Kjo lloj fushate zgjedhore nuk është në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale por trajtimi i të dhënave personale duhet domosdoshmërisht të jetë në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave. Kjo nuk është vetëm në interesin e kandidatëve për të vepruar në mënyrë të ligjshme, por gjithashtu edhe në respektimin e privatësisë së individëve që kërkojnë të përfaqësohen duke i trajtuar të dhënat e tyre në mënyrë të drejtë. Mbledhja e të dhënave nga lista të ndryshme anëtarësimi si psh, në institucionet arsimore, organizata të ndryshme etj, dhe përdorimi i tyre nga kandidatët për kryerjen e fushatës zgjedhore sipas këtij udhëzimi është një formë e paligjshme e përpunimit dhe si rrjedhojë është e ndaluar. Për mbrojtjen e të dhënave të individëve dhe kufizimin e aktiviteteve të mashtrimit (fraud), Udhëzimi parashikon se për aktivitetin e tregtimit të drejtpërdrejtë me SMS, kandidatet duhet të nënshkruajnë Marrëveshje për Përpunimin e të Dhënave me operatorët celularë, për SMS që i dërgohen pajtimtarëve të tyre përkatës.

Pse përbën tregtim të drejtpërdrejt ky aktivitet politik? Themi se ky aktivitet përbën tregtim të drejtpërdrejtë pasi nga një këndvështrim i zgjeruar i përkufizimit, tregtimi i drejtpërdrejtë nuk është vetëm shitja e mallrave dhe shërbimeve por përfshin gjithashtu promovimin e qëllimeve dhe idealeve të çdo organizate duke përfshirë edhe partitë politike. I tillë është inkurajimi i individëve që të votojnë për një parti apo kandidat të veçantë. Tregtimi përfshin komunikimin “drejtuar një individ të veçantë”, kështu që shpërndarja e fletëpalosjeve apo emaile të pa adresuara nuk përfshihen në fushëveprimin e këtij udhëzimi. Në rast se të dhënat e përpunuara i përkasin pikëpamjeve politike, opinioneve, ndonjë treguesi të votimit etj, sipas Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, përcaktohen si të dhëna sensitive. Për këtë arsye përpunimi i këtyre të dhënave i nënshtrohet marrjes së disa masave shtesë për mbrojtjen e tyre, si psh. shkatërrimi në mënyrë të sigurt i tyre në fund të fushatës.

Në rastet kur kandidati përdor të dhënat personale të përpunuara për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë, si psh. kur kandidati kontakton me zgjedhësit nëpërmjet mesazheve telefonike, e-mail, me postë, duhet që më parë të ketë marrë pëlqimin e tyre. Një shembull i tregtimit të drejtpërdrejtë që mund të bëjë një kandidat apo parti politike është rasti kur realizohet një telefonatë e cila kërkon një opinion individual me qëllim që të përdorë këto të dhëna për të identifikuar personat e mundshëm që mbështesin atë parti politike dhe në një të ardhme i përdorin këto të dhëna për marketing të mëtejshëm.

Gjithashtu, zgjedhësve i jepet e drejta për të tërhequr pëlqimin e dhënë për tregtim të drejtpërdrejtë, në çdo kohë. Për të lehtësuar punën e tyre, kandidatët/partitë politike duhet të mbajnë një listë me emrat e zgjedhësve të cilët kanë ushtruar të drejtën e tyre, atë të

kundërshtimit të të gjithë komunikimeve të ardhshme dhe në këtë rast kandidati duhet të ndjekë një procedurë për të siguruar që ky zgjedhës të mos marrë më komunikime të tilla të padëshiruara duke respektuar dëshirën e tyre për të mos i kontaktuar më.